



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1360 prot.

Elbasan, më 09.06.2025

VENDIM

Nr. 51 datë 09.06.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 20, DATË 05.04.2020, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË STUDIMEVE TË FAKULTETIT EKONOMIK TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT 'ALEKSANDËR XHUVANI'"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma "d", Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 9, gërma "d"; si dhe bazuar në propozimin e Dekanatit të Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë, Senati Akademik

V E N D O S I:

- I. Në Vendimin e Senatit Akademik nr. 20 datë 05.04.2020 "Për miratimin e rregullores së studimeve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 1. Kudo në tekstin e Rregullores emërtimi "Fakulteti Ekonomik" zëvendësohet me emërtimin "Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë".
 2. Pika 7 e nenit 42 të Rregullores ndryshohet si më poshtë:

7. Vlerësimi përfundimtar bazohet në shumatoren e pikëve të përfutur nga vlerësimi i vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimi në provimin përfundimtar, sipas skemës së vlerësimit të kësaj rregulloreje.
 3. Pika 4 e nenit 43 të Rregullores ndryshohet si më poshtë:

4. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit. Tezat e provimit duhet të rinovohen çdo vit akademik dhe të firmosen nga drejtuesi i departamentit para zhvillimit të provimit. Një kopje e tezave të provimit depozitohet tek drejtuesi i njësisë bazë.
 4. pika 2 e nenit 44 të Rregullores ndryshohet si më poshtë:

2. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë). Skema e vlerësimit është: 0-40 pikë (%): nota 4; 41-50 pikë (%): nota 5; 51-60 pikë (%):

nota 6; 61-70 pikë (%): nota 7; 71-80 pikë (%): nota 8; 81-90 pikë (%): nota 9; 91-100 pikë (%): nota 10.

5. Në nenin 47 pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:

14/1: Gjatë zhvillimit të provimit, në çfarëdo forme të kryerjes së tij (shkrim, gojë, apo e kombinuar) pedagogu konfirmon prezencën e studentëve në provim me anë të një liste emërore, tek e cila firmos çdo student që merret në provim. Pas përfundimit të provimit kjo listë dorëzohet tek drejtuesi i departamentit.

6. Në fund të pikës 1 të nenit 51 të Rregullores shtohet togfjalëshi “ose sezonet e posaçme të shpallura nga dekanati”.

7. Pas pikës 3 të nenit 51 të Rregullores shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

4. Në çdo sezon të provimeve, drejtuesi i njësisë bazë ngre komisionin e provimit duke patur parasysh që studentët përsëritës dhe ata që kanë provime të mbartura, të cilët kanë rezultuar jo-kalues të paktën 2 (dy) herë në provimin në të cilin janë paraqitur, iu caktohet komision i ri provimi. Këta studentë evidentohen nga sekretaria mësimore dhe lista e tyre u vëhet në dispozicion drejtuesve të njësisë bazë dy ditë përpara provimit.

II. Ngarkohet Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

